

BASHKIMI
EVROPIAN
SQARON



Ndërtimi i një
zone evropiane
të drejtësisë

Drejtësia, të drejtat themelore dhe barazia

Drejtësi për qytetarët dhe drejtësi për
zhvillim: një zonë e vërtetë evropiane
e drejtësisë do të përmirësojë jetët e
qytetarëve dhe -do t'u mundësojë
bizneseve që të shfrytëzojnë
plotësisht tregun e vetëm.



BASHKIMI EVROPIAN SQARON

Ky publikim është pjesë e një numri publikimesh që sqaron se çfarë bën BE-ja në fusha të ndryshme politikash, pse BE-ja është e përfshirë dhe se cilat janë rezultatet.

Këto publikime mund t'i gjeni online në:

http://europa.eu/pol/index_en.htm

<http://europa.eu/!bY34KD>

Si funksionon BE
Evropa në 12 mësim
Evropa 2020: strategjia e zhvillimit të Evropës
Themeluesit e BE-së

AgriBujqësia
Bankat dhe financat
Kufijtë dhe siguria
Buxheti
Veprimi klimatik
Konkurrenca
Konsumatorët
Kultura dhe aspekti audiovizual
Doganat
Agjenda digjitale
Bashkimi ekonomik dhe monetar dhe Euro
Arsimi, trajnimi, rinia dhe sporti
Punësimi dhe çështjet sociale
Energjia
Zgjerimi
Ndërmarrja
Mjedisi
Luftimi i mashtrimit
Siguria e ushqimit
Çështjet e jashtme dhe politika e sigurisë
Ndihma humanitare dhe mbrojtja civile
Tregu i brendshëm
Bashkëpunimi dhe zhvillimi ndërkombëtar
Drejtësia, të drejtat themelore dhe barazia ✖
Çështjet bregdetare dhe peshkimi
Migrimi dhe azili
Shëndeti publik
Politika rajonale
Hulumtimi dhe inovacioni
Tatimi
Tregtia
Transporti

PËRMBAJTJA

Pse na duhen politika efektive të drejtësisë. 3

Si është qasja e BE-së për këtë: mjetet dhe caqet 5

Çfarë bën BE: përmirësimi i jetës së përditshme të qytetarëve dhe bizneseve. 9

Pikëpamja: dhënia e mundësisë për qytetarët dhe promovimi i zhvillimit 14

Më shumë informata. 16

BE sqaron:

Drejtësia, të drejtat themelore dhe barazia

Komisioni Evropian
Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim
Informata për qytetarë
1049 Bruksel
BELGIKË

Transkripti ka përfunduar në nëntor 2014

Kopertina dhe fotografia në faqe 2: © iStockphoto.com/J.L.Bulcao

16 pp. — 21 × 29.7 cm
ISBN 978-92-9238-209-4
doi:10.2871/759962

Luksemburg:
Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2014

© Bashkimi Evropian, 2014
Autorizohet edhe riprodhimi. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive individuale duhet të kërkohet leje drejtpërdrejtë nga përgjegjësit e të drejtave autoriale.

Pse na duhen politika efektive të drejtësisë

Në një Evropë me kufij të hapur, gjithnjë e më shumë njerëz jetojnë, punojnë, studiojnë dhe bëjnë biznes në vendet e tjera të Bashkimit Evropian (BE). BE-ja ua lehtëson qytetarëve ushtrimin e të drejtave të tyre përmes krijimit të një zone të vërtetë evropiane të drejtësisë. BE-ja përpaket të fuqizojë besimin e ndërsjellë në mes të gjykatave dhe administratave të 28 vendeve të BE-së, në mënyrë që ato t'i njohin dyanshëm vendimet gjyqësore të njëra-tjetrës. Harmonizimi i rregullave gjyqësore dhe i standardeve minimale në BE si dhe qasja në drejtësi, në marrëdhënie të barabarta në të gjitha vendet, janë çështjet kryesore për një zonë të përbashkët të drejtësisë. Po ashtu, BE-ja është duke punuar që t'u mundësojë qytetarëve dhe bizneseve të shfrytëzojnë plotësisht tregun e saj të vetëm.

Ofrimi i zgjidhjeve praktike

Politikat e drejtësisë së BE-së synojnë të lehtësojnë ushtrimin e të drejtave nga qytetarët e saj dhe bizneset dhe të ofrojnë zgjidhje praktike në problemet ndër-kufitare. Ende disa qytetarë evropianë ballafaqohen me pengesa, si p.sh. jetesë, udhëtim, studim ose punë në ndonjë vend tjetër të BE-së. Bizneset mund të ballafaqohen me probleme që kanë të bëjnë me diferencat në ligjet për kontrata, legjislacion tatimor ose për konsumatorë, kërkesa administrative ose rregulla për mbrojtjen e të dhënave. BE-ja ofron zgjidhje praktike për problemet ndër-kufitare dhe kështu ndihmon në zgjidhjen e potencialit të plotë të tregut të vetëm. Si rezultat, qytetarët ndihen të sigurt dhe besojnë se të drejtat e tyre mbrohen, pa marrë parasysh se cilës pjesë të BE-së i takojnë. Në të njëjtën kohë, duke zvogëluar burokracinë e tepërt dhe duke krijuar siguri ligjore, për të cilën kanë nevojë bizneset në mënyrë që të përfitojnë nga mundësitë

Qytetarët duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre edhe kur janë jashtë vendit të tyre diku në BE.



e tregut të vetëm, ata fillojnë të mbështeten në ligjin e BE-së dhe t'i besojnë atij.

Objektivat aktuale

Objektiva themelore e BE-së është zhvillimi i një zone të vërtetë evropiane të drejtësisë, bazuar në njohjen dhe besimin e ndërsjellë. Qytetarët, konsumatorët dhe bizneset duhet të jenë në gjendje të mbështeten dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre brenda kufijve kombëtarë dhe ndër-mjet kufijve kombëtarë. Kjo kërkon respektimin e plotë të sundimit të ligjit, të të drejtave themelore dhe të pavarësisë së gjyqësorit. BE-ja dëshiron të mundësojë “drejtësi për qytetarët dhe drejtësi për zgjerimin”. Fushat prej të cilave qytetarët dhe bizneset mund të presin më së shumti nga politikëbërja në Evropë janë:

E drejta civile: Në një Evropë me kufij të hapur, është e qartë se në rrethana të caktuara një qytetar i një shteti të BE-së mund të gjendet përballë një gjykate në një shtet tjetër të BE-së. Për të ndihmuar këto raste, BE-ja promovon qasje më të mirë në drejtësi, njohje të ndërsjellë të vendimeve gjyqësore dhe rritje të konvergencës në fushën e së drejtës procedurale. Rregullat e përbashkëta procedurale evropiane synojnë t'u ndihmojnë familjeve me prapavijë ndërkombëtare për të zgjidhur problemet e vështira, si divorcin, konfliktet mbi kujdestarinë ose pasojat e vdekjes së një anëtar i familjes.

Që nga viti 1992, tregu i vetëm u ka mundësuar qytetarëve dhe bizneseve që të lëvizin dhe të tregtojnë lirshëm nëpër kufijtë brenda BE-së. Tregu i vetëm ende nuk është kompletuar plotësisht, meqë bizneset dhe konsumatorët ende ballafaqohen me probleme, si pengesat lidhur me ligjin për kontrata, ndryshimet në tatim ose kërkesat legjislative dhe administrative për konsumatorë. Për më tej, numri i konsiderueshëm i ligjeve të nxjerra gjatë 20 viteve të fundit për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve ende duhet të fuqizohet më tej dhe t'u përshtatet modeleve ndryshuese të bizneseve dhe modeleve të konsumit. Për më shumë informata rreth politikës së BE-së për konsumatorë, shihni broshurën “Konsumatorët”, që është pjesë e këtyre publikimeve.

E drejta penale: Shpesh është një dimension evropian për çështjet kriminale. Për shembull, në rastet kur dyshohet se një organizatë kriminale operon në disa vende të BE-së ose kur një kriminel i dyshuar fshihet në një vend tjetër të BE-së, bashkëpunimi gjyqësor është i nevojshëm. Bashkëpunimi i tillë përfshin fuqizimin e dialogut dhe veprimit në mes të autoriteteve të drejtësisë

penale të vendeve të BE-së. Në këtë drejtim, BE po zhvillon zonën evropiane të drejtësisë penale, ku organet për zbatimin e ligjit dhe gjyqësorët mund t'i besojnë dhe të mbështeten plotësisht në njëri-tjetrin. Kjo do të rrisë besimin e qytetarëve në paanësinë e procedurave penale, veçanërisht lidhur me mbrojtjen e të drejtave të tyre gjatë procedurave gjyqësore në një vend tjetër ose nëse ata bien viktimë e një krimi atje.

Të drejtat themelore: Statuti i të Drejtave Themelore i Bashkimit Evropian është bërë një dokument ligjor detyrues me hyrjen e tij në fuqi në Traktatin e Lisbonës më 2009. Veprimet e BE-së duhet të jenë aq perfekte kur është fjala për të drejtat themelore dhe ajo duhet të sigurojë që të drejtat e përcaktuara në këtë Statut konsiderohen me shumë kujdes. Statuti duhet të shërbejë si një përmbledhje e politikave të Bashkimit dhe implementimit të tyre nga shtetet e BE-së

Shtetësia e BE-së: Shtetësia e BE-së është akorduar automatikisht në të gjitha qeveritë e shteteve të BE-së dhe ajo siguron për secilin qytetar të Bashkimit një numër plotësues të të drejtave, të cilat kanë ndikim konkret dhe pozitiv në jetën e tyre të përditshme. BE-ja monitoron implementimin dhe aplikimin e të drejtave të shtetësisë së BE-së nga shtetet anëtare, siç përcaktohet me Traktat, për të siguruar se qytetarët e BE-së i kanë në të vërtetë këto të drejta.

Barazia: Barazia gjinore dhe jo-diskriminimi janë ndër vlerat themelore të BE-së. BE-ja vepron në emër të qytetarëve për të parandaluar diskriminimin mbi bazë të gjinisë, racës ose përkatësisë etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës dhe orientimit seksual. Këtë e bën përmes mjeteve legislative, financimit dhe politikave në fushat që kanë të bëjnë me të gjitha këto kategori, si punësimi dhe qasja në mallra dhe shërbime, në mënyrë të barabartë për personat me aftësi të kufizuara. BE-ja synon të forcojë edhe më tej barazinë gjinore përmes BE-së, duke zvogëluar dallimin në paga sipas gjinisë dhe duke rritur numrin e grave në pozita me përgjegjësi, veçanërisht në politikë dhe biznes, si dhe duke parandaluar dhunën gjinore dhe duke përmirësuar mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave.

Shqyrtimi i përbashkët — lidhjet me fushat e tjera të politikave


Politikat gjyqësore ndërtohen bazuar në qëllimet e ndërthurura të “Drejtësisë për qytetarët” dhe “Drejtësisë për zgjerimin” dhe ato i kontribuojnë strategjisë **Evropa 2020** — agjendës së BE-së për zgjerim në dhjetëvjetëshin e ardhshëm.

BE-ja është duke punuar në disa fusha të politikave për të siguruar se qytetarët e BE-së i gëzojnë të drejtat e tyre plotësisht në jetën e tyre të përditshme. **Raporti i shtetësisë së BE-së**, i publikuar në vitin 2013, është bazuar në të arriturat e raportit të parë të këtij lloji, që ishte miratuar në vitin 2010 dhe ai paraqet 12 veprimet kryesore të cilat i ndërmerr Komisioni Evropian për të përmirësuar jetesën e qytetarëve të BE-së, me theks të veçantë në situatat ndër-kufitare. Një pasqyrë e progresit tregon të arriturat përmes implementimit të veprimeve nxjerra në Raportin e Shtetësisë 2010.

Përkundër të arritave të deritanishme, tregu i vetëm ende nuk është arritur. Politikat e “Drejtësisë për Zgjerim” synojnë rregullat e qarta komerciale dhe ato për konsumatorin, si dhe zgjidhjen efikase të konflikteve si në nivel vendor ashtu edhe në nivel të BE-së. Këto politika lehtësojnë tregtinë ndër-kufitare dhe u mundësojnë kompanive dhe konsumatorëve që të shfrytëzojnë më mirë mundësitë e ofruara nga tregu i brendshëm dhe në këtë mënyrë ndihmojnë në rritjen e potencialit të tregut të vetëm.

Qoftë nëse punojnë në vendin e tyre ose në një vend tjetër të BE-së, qytetarët kanë të drejta të caktuara minimale që ndërlidhen me jo-diskriminimin, shëndetin dhe sigurinë në punë, mundësi të barabarta për gratë dhe burrat dhe trajtim i barabartë në punë. Ata kanë të drejtë të kenë një nivel të lartë mbrojtjeje për konsumin. Me **Agjendën e tij evropiane për Konsumatorin**, Komisioni Evropian ka publikuar strategjinë e tij të përgjithshme që do të implementohet nëpër të gjitha politikat e BE-së.

PËRQINDJA E GRAVE DHE BURRAVE NË BORDE TË KOMPANIVE TË PËRMENDURA MË SË SHUMTI PUBLIKISHT 2012



Si funksionon BE në këtë drejtim: mjetet dhe caqet

Korniza ligjore

Traktati i Lisbonës ka hyrë në fuqi në dhjetor 2009. Ky traktat fuqizon demokracinë në BE dhe kapacitetin e saj për të promovuar interesat e qytetarëve për çdo ditë. Duke i vënë qytetarët në qendër të politikave të BE-së, Traktati i Lisbonës ka revolucionuar në mënyrë efektive politikbërjen e BE-së në fushën e drejtësisë, të drejtave themelore dhe shtetësisë.

Që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës, BE-ja tani ka mandatin për të nxjerrë ligje në fushën e së drejtës penale.

Për më tepër, **Statuti i Bashkimit Evropian për të Drejtat e Njeriut** është formuar si detyrim i dalë nga Traktati i Lisbonës. Institucionet e BE-së duhet të respektojnë të drejtat e promovuara në këtë Statut. Ky Statut aplikohet edhe në vendet e BE-së, në rastet e zbatimit të ligjit të BE-së.

Që nga fillimi i vitit 2011, Bashkimi Evropian ka qenë pjesë e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD), duke u bërë që këtë pjesë e rendit ligjor të BE-së. Kjo nënkupton se UNCRPD është detyrues për Bashkimin Evropian dhe ai përbën një pjesë të ligjit të BE-së.

Drejtësi për qytetarët

Çdo qytetar i një shteti anëtar të BE-së është edhe qytetar i BE-së. Shtetësia e BE-së nuk zëvendëson shtetësinë kombëtare. Mirëpo, ajo i jep të gjithë qytetarëve të BE-së një numër plotësues të drejtash, të garantuara nga Traktatet e BE-së, të cilat i përkasin pjesës kryesore të jetës së përditshme. Këto të drejta janë:

- mundësia për të udhëtuar dhe jetuar kudo në BE;
- të mos jesh i diskriminuar mbi bazë të nacionalitetit;
- të mund të votosh dhe të jesh kandidat në zgjedhjet komunale dhe të Parlamentit Evropian në vendbanimin tënd, pa marrë parasysh nacionalitetin;
- të ndihmohesh nga ndonjë ambasadë ose konsullatë tjetër e vendeve të BE-së jashtë BE-së, me kushte të njëjta si çdo qytetar i atij vendi;
- të mund të bësh kërkesë në Parlamentin Evropian dhe paraqitësh raste te Avokati i Popullit Evropian;
- të iniciosh ose të nënshkruash, bashkë me qytetarët e tjerë të BE-së, një iniciativë qytetare për thirrje për legjislacion të ri të BE-së.

BE-ja ka vendosur rregulla për të garantuar këto të drejta dhe po përpaket të sigurojë se qytetarët e saj i gëzojnë këto të drejta lirshëm dhe pa pengesa.

Përhapja gjithnjë e në rritje e lëvizjes së lirë të personave, mallrave dhe shërbimeve rezulton pashmangshëm në rritje të numrit të konflikteve ndër-kufitare. BE-ja ka nxjerrë një numër procedurash që kanë për qëllim t'u ndihmojnë individëve në çështjet gjyqësore ndër-kufitare. Për shembull, vendimet gjyqësore që merren nga gjykata e një prej shteteve anëtare njihen dhe zbatohen në të gjitha shtetet e tjera anëtare. BE-ja synon të sigurojë që qytetarët mund t'i drejtohen gjykatave dhe autoriteteve në çdo vend të BE-së lirshëm sikurse të ishin në vendin e tyre. Duke synuar një siguri ligjore për qytetarët e BE-së në konfliktet ligjore familjare ndër-kufitare, viteve të fundit BE ka miratuar disa instrumente ligjore dhe po negocion edhe mjete të tjera të rëndësishme.

Gjatë udhëtimit jashtë vendit, secili ballafaqohet me rrezikun e të qenit viktimë e një krimi ose të qenit i akuzuar ose i dyshuar për një kundërvajtje penale. BE-ja po punon në një numër "të drejtash gjyqësore të paanshme" që do të zbatohen kudo në BE, të cilat janë përgatitur për vendosjen e standardeve minimale të përbashkëta të BE-së në rastet penale. Tashmë në ligj janë përfshirë të drejtat e të pandehurve për informacione, përkthim dhe interpretim gjatë procedurave gjyqësore kudo në BE dhe të drejtat për adresim të ndonjë avokat dhe për të komunikuar në rastin e arrestimit. Të gjitha këto udhëzime garantojnë të drejta gjyqësore të paanshme që nga faza e parë e marrjes në pyetje në polici e deri te procedurat gjyqësore. Tani është duke u diskutuar një pako e re e propozimeve legjislative për fuqizimin e kujdesit procedural për qytetarët në procedura penale. Ajo adreson parimin e supozimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë i pranishëm në aktgjykim, mbrojtje të veçantë për fëmijët e dyshuar dhe të akuzuar dhe ofrim i ndihmës ligjore. Përveç kësaj, BE fuqizon të drejtat e qytetarëve dhe paraqet një numër standardesh minimale për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit ose dhunës. Të drejtat e viktimave janë të drejta themelore, përfshirë këtu respektin për dinjitetin human, jetën private dhe familjare dhe pronën.

Të drejtat dhe liritë

Statuti i të Drejtave Themelore i BE-së përmban gjashtë të drejtat themelore dhe liritë e mbrojtura në BE, të cilat janë:

- *dinjiteti*
- *liritë*
- *barazia*
- *solidariteti*
- *të drejtat e qytetarëve*
- *drejtësia.*

I shpallur në vitin 2000, Statuti është bërë një dokument ligjor në BE me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës në dhjetor të vitit 2009.

Ky Statut duhet të respektohet nga institucionet e BE-së dhe nga autoritetet kombëtare, përfshirë këtu gjykatat, kur është fjala për zbatimin e ligjit të BE-së. Për shembull, ky Statut aplikohet kur shtete e BE-së miratojnë ose zbatojnë një ligj kombëtar, kur implementojnë një udhëzim të BE-së ose kur autoritete e tyre aplikojnë drejtpërdrejt një rregullore të BE-së. Megjithatë, Statuti i të Drejtave Themelore nuk përfshin edhe kompetencën e BE-së për çështjet që nuk janë të përfshira në Traktate.


Në rastet kur nuk aplikohet Statuti, mbrojtja e të drejtave themelore garantohet me kushtetuta ose tradita kushtetuese të shteteve të BE-së ose ndonjë konventë ndërkombëtare që ato kanë ratifikuar.

Ku duhet të adresoheni nëse besoni se të drejtat tuaja themelore janë shkelur? Konsultoni portalin evropian "e-Justice"!

<http://e-justice.europa.eu/>

KARTA E TË DREJTAVE THEMELORE EVROPIANE

Kur zbatohet dhe ku duhet të drejtoheni në rast të shkeljes?



Barazia dhe jo-diskriminimi janë të drejtat e tjera që ruhen me këtë Statut. Për shumë vjet, veprimi i BE-së në fushën e mosdiskriminimit është fokusuar në parandalimin e diskriminimit mbi bazë të nacionalitetit dhe gjinisë. Më pas, shtetet anëtare ranë dakord njëzëri për t'i dhënë fuqi të reja BE-së për të luftuar diskriminimin në çështjet e punësimit mbi baza të përkatësisë racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës dhe orientimit seksual. Sot, BE ka legjislacionin plotësues për të siguruar trajtim të barabartë dhe për të parandaluar diskriminimin në çështjet e sigurimit shoqëror dhe qasjes në mallra dhe shërbime.

Në BE, secili ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe rregullat e përbashkëta janë krijuar për të siguruar që individët gëzojnë një standard të lartë të mbrojtjes kudo në BE. Një reformë e këtyre rregullave u propozua në fillim të vitit 2012 me qëllim të forcimit të së drejtave të individëve dhe trajtimit të sfidave të globalizimit dhe të teknologjive të reja.

Drejtësia për zhvillim

Sot në BE bizneset ballafaqohen me kërkesa të ndryshme dhe ndonjëherë edhe kontradiktore për mbrojtjen e të dhënave, për shkak të ligjeve të ndryshme kombëtare në fuqi. Po ashtu për mbrojtjen e privatësisë individuale, reforma e lartpërmendur e rregullave për mbrojtjen e të dhënave ka për qëllim eliminimin e barrës së komplikuar administrative, si dhe eliminimin e shpenzimeve të tjera të lidhura me kërkesat e ndryshme për mbrojtjen e të dhënave, të cilat aktualisht ekzistojnë në të gjithë BE-në. Me rregulla të harmonizuara më mirë për mbrojtjen e të dhënave personale në gjithë BE-në, konsumatorët mund të ndihen më të sigurt kur blejnë mallra dhe shërbime në internet. Ky është një hap i rëndësishëm drejt sigurimit që tregtia elektronike kontribuon plotësisht në rritjen ekonomike aq të nevojshme dhe në krijimin e vendeve të punës.

Kjo është arsyeja pse Komisioni Evropian përditëson legjislacionin e BE-së për konsumatorë dhe e përshtat atë me praktikatat aktuale në internet, dhe më së fundi këtë e bën përmes përfshirjes së direktivës për **të drejtat e konsumatorëve**, e cila filloi së zbatuari më 13 qershor 2014. Afro 500 milionë konsumatorë evropianë përbëjnë një kontribut të rëndësishëm në nxitjen e rimëkëmbjes ekonomike në BE. Prandaj, legjislacioni aktual përcakton standarde të larta të mbrojtjes së konsumatorit në BE dhe midis fushash tjera mbulon edhe praktikatat e padrejta të marketingut, të tilla si: reklamata mashtruese, rregullat për kontratat e konsumatorëve, p.sh. për kushtet e padrejta të kontratave, garancitë e produkteve dhe detyrimet informative (Më shumë informacione në lidhje me të




© Pavel Černoch

Komisioni Evropian ka propozuar një pako reformash për mbrojtjen e të dhënave në mënyrë që të rrisë ekonominë digjitale të Evropës dhe të forcojë mbrojtjen e të dhënave personale në internet: Merrni kontrollin e të dhënave tuaja personale!

drejtat e konsumatorëve mund të gjenden në publikimin "Konsumatorët").

BE-ja është duke punuar për një qasje më të mirë në mallra dhe shërbime në tregun evropian. Kjo ka të bëjë jo vetëm me mallrat dhe shërbimet për përdorim të përditshëm me karakteristika të qasjes për personat me aftësi të kufizuara, por edhe me të moshuarit dhe shumë të tjerë. Një funksionimi më i mirë i tregut të brendshëm të këtyre mallrave dhe shërbimeve do të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe do ta bëjë më të lehtë për kompanitë që operojnë në të gjithë BE-në.

Pengesat në tregtinë ndërkufitare ende vazhdojnë. Tregtarët duhet të respektojnë rregulla të ndryshme të ligjit vendor për kontratat në qoftë se ata duan të shesin produktet e tyre në vendet e tjera të BE. Kjo është e kushtueshme dhe i pamundëson shumë tregtarë që të bëjnë biznes me klientët jashtë vendit. Për të kapërcyer këtë problem, në vitin 2011 Komisioni Evropian propozoi "Ligjin e përbashkët evropian për shitje", me qëllim të kompletimit të një tregu të vetëm, nxitjes së rritjes dhe krijimit të vendeve të punës. Nga njëra anë, qëllimi është për të lehtësuar tregtinë përmes ofrimit të një pakoje të vetme rregullash për kontratat e shitjes ndërkufitare kudo në BE. Nëse tregtarët ofrojnë produktet e tyre në bazë të një ligjit të përbashkët evropian për shitje, konsumatorët do të kenë mundësinë e zgjedhjes së një kontrate evropiane, që është e lehtë për përdoruesit dhe me një nivel të lartë të mbrojtjes. Në anën tjetër, ky propozim gjithashtu promovon tregun e vetëm digjital, përmes ofrimit të një pakoje të vetme rregullash për plotësimin e përmbajtjes digjitale.

INTERESI NË NJË LIGJ TË PËRBASHKËT EVROPIAN PËR SHITJE ⁽¹⁾

(¹) Një studim i kohëve të fundit tregon një interesim të qartë të biznesit. Grafiku tregon përgjigjet e bizneseve në pyetjen nëse ata mund të përdorin një ligj kontrate evropian për konsumatorët për shitjet ndërkufitare të konsumatorët në BE.

Sistemet efikase të drejtësisë dhe një mjedis i shëndoshë rregullativ mund të japë një kontribut të madh në nxitjen e rritjes ekonomike në Evropë. Në sajë të ligjit të BE-së, gjykimet komerciale njihen automatikisht në të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Zgjidhjet mund të jenë të thjeshta dhe me kosto të ulët dhe akoma mund të injektojnë efikasitetin aq të nevojshëm në sistemet evropiane të drejtësisë dhe të nxisin zhvillimin. BE-ja mbështet ndërmjetësimin dhe mekanizmat alternativë për zgjidhjen e kontesteve (ADR), si alternativa më të shpejta dhe më të lira se sa shkuarja në gjyq. Ndërmjetësimi dhe ADR u japin qytetarëve dhe bizneseve mundësinë e zgjidhjes së konflikteve të tyre jashtë gjykatës. Kjo u kursen kohë dhe para. Mund të zgjidhë mosmarrëveshjet ndërmjet bizneseve, punëdhënësve dhe punëtorëve, qiradhenësve dhe qiramarrësve, ose familjeve, në mënyrë që ata të mund të kenë marrëdhënie të mira dhe madje edhe të forcojnë marrëdhëniet e tyre në mënyrë konstruktive - një rezultat që nuk mund të arrihet gjithmonë përmes procedurës gjyqësore. Në të njëjtën kohë, një marrëveshje e arritur me anë të ndërmjetësimit është e detyrueshme dhe mund të zbatohet.

Financimi i politikave të drejtësisë

BE-ja është duke financuar dy programe, "Programin për Drejtësi" dhe "Programin e të drejtave, barazisë dhe shtetësisë", të cilat do të implementohen gjatë periudhës 2014-20 me një buxhet të përgjithshëm prej 817 milionë €. Të dyja janë të thjeshta dhe më efikase në kuptimin e menaxhimit në krahasim me programet e mëparshme dhe ato do të konsolidojnë gjashtë programet ekzistuese të financimit në fushën e drejtësisë dhe të së drejtave. Programi i Drejtësisë ka për qëllim që të sigurojë që legjislacioni i BE-së në çështjet civile dhe penale aplikohet në mënyrë efektive. Kjo do t'i ndihmojë qytetarët dhe bizneset për të pasur qasjen e duhur në drejtësi në rastet ligjore ndërkufitare në Evropë. Ky program gjithashtu do të mbështesë veprimet e BE-së që kanë për qëllim trajtimin e drogës dhe krimit. Programi për të Drejtat, Barazinë dhe Shtetësinë do të ndihmojë në efikasitetin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve në praktikë përmes informimit më të mirë dhe aplikimit të tyre në mënyrë konsistente kudo në BE. Ai do të promovojë të drejtat e fëmijëve, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e shtetësisë, mbrojtjen e të dhënave, barazinë gjinore dhe parimin e mos-diskriminimit. Gjithashtu, ky program do të luftojë racizmin, ksenofobinë, homofobinë dhe dhunën ndaj grave dhe fëmijëve.

Çfarë bën BE-ja: përmirësimi i jetës së përditshme të qytetarëve dhe bizneseve

Të arriturat deri më tash

Drejtësia, të drejtat themelore dhe politikat e nënshtetësisë bazohen në vlerat dhe parimet më të dashura për evropianët, si demokracia, liria, toleranca dhe sundimi i ligjit.

Gjatë 50 viteve të fundit, BE-ja ka ndërmarrë hapa vendimtarë drejt një zone evropiane të drejtësisë. Në vitin 1968 është arritur konventa e parë mbi juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve civile dhe penale. Në vitin 1970 Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka vendosur se barazia është një e drejtë themelore. Që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës, Karta e të Drejtave Themelore e BE-së është bërë ligjërishit detyruese për BE-në dhe të drejtat themelore janë parimet e përgjithshme të ligjit të BE-së. Që nga viti 1992, tregu i vetëm u ka mundësuar qytetarëve dhe bizneseve që të tregtojnë lirisht kudo brenda kufijve të BE-së. Gjatë të njëjtës periudhë, është zhvilluar edhe një grup i konsiderueshëm ligjesh për të mbrojtur interesat ekonomike të konsumatorëve dhe për të ruajtur nivelin e tyre të tanishëm të lartë të mbrojtjes. Më 1993, është krijuar zyrtarisht shtetësia evropiane dhe që atëherë secili prej nesh në Evropë ka të drejta shtetë: të drejtën për të jetuar, për të udhëtuar, për të studiuar, për të punuar, për të dalë në pension, për të blerë, për t'u martuar, për të pasur kujdes shëndetësor dhe për të marrë pjesë në jetën demokratike - kudo në BE.

Qytetarët

Shembujt e mëposhtëm që përfaqësojnë arritjet në drejtësi për qytetarët tregojnë se si këto politika kanë pasur ndikim në përmirësimin e jetës së përditshme të qytetarëve.

Ndërsa qytetarët udhëtojnë lirshëm brenda BE-së, është e rëndësishme që ata të gëzojnë qasje të pakufizuar në sistemin gjyqësor të vendit ku jetojnë. Bashkëpunimi është intensifikuar ndërmjet autoriteteve gjyqësore kombëtare për të siguruar që vendimet ligjore të marra në një vend njihen dhe zbatohen në çdo vend tjetër në BE. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në të drejtën familjare. Me një numër në rritje të njerëzve që jetojnë në vendet e BE-së, në vende të tjera prej shteteve të tyre, po formohen edhe familje më ndërkombëtare. Në rastet kur çiftet ndërkombëtare me fëmijë ndahen, rregullat e BE-së për divorc, kujdestari dhe kërkesa për kujdes financiar të fëmijës inkurajojnë zgjidhjet miqësore dhe japin siguri ligjore mbi juridiksionin dhe

ligjin në fuqi aty ku mosmarrëveshjet dërgohen në gjykatë.

Eva nga Hungaria dhe Rolf nga Gjermania jetojnë në Itali. Ata kanë një vajzë, Anna-n. Pas disa vitesh, Eva donte të divorcohej. Falë rregullave të BE-së, Eva ishte në gjendje të paraqesë kërkesën për divorc në Itali. Meqë Eva dhe Rolf janë në marrëdhënie të mira, ata nënshkruan një marrëveshje përmes së cilës zgjedhën ligjin gjerman për divorcin e tyre, të cilin e zbatoi gjykata italiane. Meqenëse vajza e Evas dhe Rolfit, Anna, jeton po ashtu në Itali, gjykata italiane mund të vendoste për kujdestarinë e Anna-s dhe të drejtat e prindërve të saj që ta vizitojnë. Sipas kërkesës së Eva-s, gjykata italiane ka përcaktuar edhe kujdesin financiar për Anna-n.

Në lidhje me testamentin dhe trashëgiminë, rregullat e BE-së që nga 2015 do të sigurojnë që zgjedhjet e qytetarëve që kanë marrë vendime para vdekjes në lidhje me pronën e tyre të njihen nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Rregullat e BE-së e bëjnë të qartë se cili autoritet është kompetent në trajtimin e trashëgimisë dhe sigurojnë që të gjitha vendimet e këtyre autoriteteve do të njihen dhe të zbatohen kudo në BE. Për më tepër, trashëgimtarët dhe administratorët e pasurive do të jenë në gjendje të dëshmojnë statusin dhe të drejtat e tyre kudo në BE, në bazë të Certifikatës Evropiane të Trashëgimisë. Kjo kornizë ligjore sjell siguri shumë të nevojshme ligjore për 450 000 trashëgimi ndërkufitare në vit në Bashkimin Evropian dhe lehtëson administrimin e pronave të trashëguara me vlerë të më shumë se 120 miliardë €.

BE-ja punon për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve gjyqësore në vendet e BE-së



Në fushën e së drejtës penale, nëse qytetarët akuzohen ose dyshohen për një vepër penale, ata mund të mbështeten në të drejtat e “grykimit të paanshëm” në gjithë BE-në

Erkki nga Finlanda udhëtoi për në Itali për pushime dhe u arrestua. Ai ka të drejtë të marrë interpretimin dhe këshilla juridike në gjuhën finlandeze gjatë gjithë procedurave gjyqësore në Itali. Erkki gjithashtu do të ketë një “Dokument për të drejtat” në gjuhën e tij amtare, i cili rendit të drejtat e tij themelore gjatë procedurës penale.

Përkrahja e të drejtave të viktimave në të gjithë BE-në është një prioritet kryesor për Evropën. Në sajë të Traktatit të Lisbonës, BE-ja tani mund të fuqizojë ligjin e BE-së. Si hap i parë, ajo ka prezantuar rregullat për të gjitha vendet e BE-së duke krijuar standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit. Kjo siguron që viktimat të njihen dhe të respektohen ashtu siç e meritojnë dhe të ketë të njëjtin nivel të mbrojtjes, mbështetjes dhe qasjes në drejtësi në të gjithë BE-në, pa marrë parasysh se nga cili vend i BE-së vijnë ose në cilin vend të BE-së jetojnë.

Anna është plaçkitur dhe rrahur në rrugë. Sulmuesi i saj u kap dhe ajo mori guximin për të shkuar në gjykatë për të dëshmuar. Falë rregullave të BE-së, Anna mund të jetë e sigurt se ajo dhe shkelësi do të mbahen larg njëri tjetrit gjatë procedurës dhe se ajo nuk do të përballet me atë.

BE-ja është duke ndërmarrë veprime për më shumë se 50 vjet për të mbrojtur parimin e pagesës së barabartë për punë të barabartë ose për punë me vlerë të barabartë. Më 1957, Traktati i Romës ka siguruar një bazë për miratimin e disa ligjeve të rëndësishme evropiane për pagesë të barabartë.

Në vitet 1970, Gabrielle Defrenne ka punuar si stjuardesë për kompaninë ajrore “Sabena”. Kjo kompani e ka paguar atë më pak se kolegët e saj meshkuj që kanë kryer të njëjtën punë. Znj. Defrenne ka kërkuar me sukses të drejtën e saj për trajtim të barabartë në bazë të barazisë gjinore para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Ky është ndoshta shembulli më i njohur i ligjit të BE-së të zbatuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Të gjithë qytetarët e BE-së kanë të drejtë për ndihmë konsullore në qoftë se ata janë jashtë BE-së, aty ku vendi i tyre nuk është i përfaqësuar. Qytetarët e BE-së mund të shkojnë në çdo konsullatë ose ambasadë tjetër të vendit të BE-së për të kërkuar ndihmë nën të njëjtat kushte si shtetasit e atij vendi të BE-së, nëse, për shembull, ata janë arrestuar, kanë pasur një aksident të rëndë ose kanë humbur dokumentet e rëndësishme. Qytetarët e BE-së kanë të drejtë edhe për ndihmë në situata të krizës. Vendet e BE-së duhet t'u ndihmojnë qytetarëve të evakohen kur është e nevojshme, sikur ata të ishin shtetas të tyre. Në **uebfaqen e mbrojtjes konsullore të**

Qasje më e lehtë në informacione

Lansimi i Portalit Evropian e-Drejtësia në vitin 2010 ishte vetëm hapi i parë në zhvillimin e një pike shumë-gjuhëshe për qasje në internet, që ua lehtëson jetën qytetarëve, bizneseve dhe praktikuesve në Evropë.

Portali Evropian e-Drejtësia është një mundësi për gjetur cdo informacion për drejtësi. Ai u siguron qytetarëve qasje të lehtë në mjetet dhe informacionet e fundit lidhur me të drejtat e secilit brenda Bashkimit Evropian dhe për të zgjidhur konfliktet qoftë brenda ose jashtë gjykatës. Ky portal është në dispozicion në 23 gjuhë!

<http://e-justice.europa.eu>

Komisionit Evropian qytetarët mund të gjejnë nëse vendi i tyre është i përfaqësuar në vendin në të cilin do të udhëtojnë.

Aristoteles nga Greqia ka udhëtuar për në Bangladesh për biznes dhe ka humbur pasaportën e tij. Meqë Greqia nuk është e përfaqësuar në Bangladesh, Aristoteles nuk e dinte se ku të drejtohej. Ai ka kontrolluar uebfaqen e mbrojtjes konsullore dhe ka kuptuar se përfaqësitë e Danimarkës, Italisë apo Gjermanisë në Daka do të mund t'i ndihmojnë atij.

Kur blejnë mallra dhe shërbime kudo në BE, qytetarët kanë të drejtë të konsumatorëve në lidhje me informacionet për produktin, me kohëzgjatjen e garancive të produktit, duke kërkuar riparim, zëvendësim ose rimbursim, duke paguar tatimin në vlerë të shtuar (TVSH) për blerjet jashtë vendit dhe duke blerë shërbime nga ndonjë vend tjetër i BE-së. Rregullat e BE-së lehtësojnë edhe kthimin e borxheve ndërkufitare..

Jean jeton në Francë dhe bleu një biçikletë nga një dyqan në Holandë, por ajo biçikletë nuk arriti kurrë. Në logarinë e tij bankare tashmë ishin tërhequr paratë për atë pagesë. Jean kontrolloi Portalin Evropian “e-Justice” dhe gjeti të gjitha informatat dhe format që i nevojiteshin për të aplikuar për procedurë të kërkesave të vogla, e cila mbulon kërkesat ndërkufitare deri në 2 000 €.

Komisioni Evropian propozon të rrisë vlerën e kërkesave që bien nën Procedurën Evropiane për Kërkesa të Vogla në 10 000€, duke e bërë atë edhe më të lehtë për përdorim.

Legjislacioni evropian i mbron konsumatorët që udhëtojnë për në pushime me pako dhe u siguron atyre mbrojtje, për shembull, në rast se një operator i organizimit të udhëtimit mbyll biznesin e tij. Udhëtarët që kanë prenotuar një pushim si paketë në BE kanë të drejtë të rimburohen ose, në qoftë se ata janë tashmë në

destinacionin e tyre të pushimeve, t'u mundësohet të kthehen në shtëpi.

Në korrik 2013, Komisioni Evropian dha një propozim për modernizimin e direktivës së BE-së të vitit 1990 për udhëtimet si paketë, e cila ka shërbyer si themel për mbrojtjen e ofruar pushuesve të BE-së. Ajo garanton mbrojtje të plotë për konsumatorët që prenotojnë pushime si paketë, të cilat përfshijnë, për shembull, kombinime të fluturimeve, hoteleve apo qiramarrjes së makinave. Kjo mbrojtje përfshin të drejtën për të marrë të gjitha informacionet e nevojshëm para nënshkrimit të kontratës, duke siguruar se njëra palë është përgjegjëse për kryerjen e të gjitha shërbimeve në paketë dhe sigurim të kthimit, në rast se një operator i udhëtimit dështon. Reforma i përgjigjet një transformimi rrënjësor të tregut të udhëtimit: qytetarët gjithnjë e më shumë po marrin një rol më aktiv në rregullimin e pushimeve të tyre sipas kërkesave specifike,

sidomos duke përdorur internetin për të kombinuar organizimin e udhëtimit të tyre në vend se të zgjedhin ndonjë pakete të gatshme nga ndonjë broshurë.

Në epokën e internetit, ku konsumatorët gjithnjë e më shumë po prenotojnë paketa në internet (qoftë nga një tregtar ose disa tregtarë të lidhur komercialisht), rregullat janë të vështira për t'u aplikuar – kjo i lë konsumatorët e pasigurt nëse ata llogarisin në mbrojtje, dhe tregtarët të pasigurt për detyrimet e tyre. Prandaj, përditësimi i rregullave të vitit 1990 është një qëllim kryesisht për ta sjellë direktivën e udhëtimeve si paketë më afër epokës digjitale. Kjo do të thotë se 120 milionë konsumatorë të tjerë që blejnë këso organizimesh të përshtatura të udhëtimit do të jenë të mbrojtur nga kjo direktivë.

Kjo reformë e propozuar do të rrisë transparencën dhe do të forcojë mbrojtjen e konsumatorëve në rast se diçka shkon keq. Bizneset do të përfitojnë po ashtu, meqë reforma do të heqë kërkesat e vjetruara të informacionit, si nevojën për ribotimin e broshurave, dhe do të sigurojë që skemat kombëtare të mbrojtjes së pamundësisë për të paguar të njihen përtej kufijve.

Udhëtarët si paketë kanë të drejtë të marrin informacione thelbësore dhe të kërkojnë ndihmë. Nëse, për shembull, hoteli nuk korrespondon me atë që ka premtuar operatori i udhëtimit, pushuesit mund të kërkojnë kompensim. Në Bashkimin Evropian, çdo vit shiten rreth 118 milionë pushime si paketë.

Kur Davidi dhe Maria prenotuan pushimet e tyre, ata vendosën për një udhëtim gjithë-përfshirës në Mesdhe. Kur ata arritën në hotel, ata zbuluan se banjo nuk kishte ujë. U ankuan pranë recepsionit dhe kërkuar për të ndryshuar dhomat, mirëpo recepsionisti u shpjegoi se nuk kishin mbetur më dhoma të lira dhe se problemi i ujit nuk mund të zgjidhej. Meqenëse Davidi dhe Maria kishin



Kur rezervoni një udhëtim jashtë vendit, ju mund të mbështeteni në mbrojtjen e konsumatorit në mbarë Evropën.

rezervuar një pushim si paketë, ata ishin të mbrojtur me rregullat e BE-së për udhëtimet si paketë dhe operatori udhëtimit ishte i detyruar që t'u bëjë një zgjidhje. Atyre u është gjetur një dhomë në një hotel tjetër dhe kështu patën mundësi t'i gëzojnë pushimet e tyre me diell.

Raportet e Shtetësisë së BE-së

Në vitin 2010, Komisioni Evropian publikoi Raportin e parë për Shtetësinë e BE-së, duke propozuar masa konkrete për t'ua lehtësuar qytetarëve të BE-së jetën kur ushtrojnë të drejtat e tyre në ndonjë vend tjetër të BE-së. Këto masa përfshijnë rastet e martesës, blerjes së një shtëpie, përfshirjen aktive në politikë, studimin, punën, kujdesin mjekësor e të tjera. Raporti i vitit 2010 përfshinte 25 veprime konkrete që kishin për qëllim lehtësimin e jetës për të gjithë qytetarët e Evropës.

Komisioni ka ndjekur këtë deri në vitin 2013, me Raportin e dytë të BE-së për Shtetësinë, i cili paraqet progresin e arritur në zbatimin e këtyre 25 veprimeve.

PËRMIRËSIMET KONKRETE NË JETËN E QYTETARËVE:

- Lehtësimi i qarkullimit të dokumenteve publike. Në prill 2013, Komisioni Evropian propozoi që qytetarët dhe bizneset nuk duhet të sigurojnë më versione "te ligjshme" aq të kushtueshme ose përkthime "të certifikuar" të dokumenteve zyrtare kur, për shembull, regjistrojnë një shtëpi apo kompani, kur martohen ose kur kërkojnë kartë qëndrimi. Heqja e këtyre kërkesave do t'u kursejë qytetarëve dhe bizneseve në BE deri në 330 milionë €, pa llogaritur kursimin e kohës dhe bezdinë që u shkaktonte.
- Heqja e burokracisë për 3.5 milionë njerëz që regjistrojnë një makinë në një vend tjetër të BE-së çdo vit. Kjo rezultoi në kursime të së paku 1.5 miliardë € në vit për bizneset, qytetarët dhe autoritetet për regjistrim.
- Propozimi për konsumatorë i zgjidhjeve të shpejta dhe të lira të kontesteve të tyre me tregtarët në BE jashtë gjykatave, duke u mundësuar atyre që të kursejnë rreth 22.5 miliardë € në vit në të gjithë Evropën.

- Informimi i qytetarëve për të drejtat e tyre të BE-së me anë të pikave informative në internet – “Evropa juaj” dhe “Evropa Direkt”.

Në raportin e Shtetësisë 2013, Komisioni Evropian ka propozuar veprime plotësuese për të vazhduar me sukseset e viteve të mëparshme.

Ky raport i ri paraqet 12 veprimet konkrete në gjashtë fusha kryesore.

- Heqja e pengesave për punëtorët dhe të trajnuarit në vendet e tjera të BE-së;
- Heqja e procedurave burokratike;
- Mbrojtja e personave më të cënueshëm;
- Eliminimi i barrierave për blerje ndër-kufitare;
- Ofrimi i informacioneve më të mira për BE-në;
- Promovimi i përfshirjes së qytetarëve në demokraci.

Të 12 veprimet e reja që kanë për qëllim fuqizimin e të drejtave të qytetarëve të BE-së janë:

1. Shqyrtimi i zgjerimit të eksportit të përfitimeve nga papunësia për më shumë se 3 muaj të obligueshëm, për t'ua bërë më të lehtë qytetarëve që të kërkojnë një vend pune në një vend tjetër të BE-së.
2. Zhvillimi i një kornize të cilësisë për trajnimet dhe modernizimin e shërbimeve evropiane të punësimit (EURES).
3. Të punohet në zgjidhjet për të hequr pengesat me të cilat ballafaqohen qytetarët e BE-së në lidhje me dokumentet e identifikimit dhe të qëndrimit, që lëshohen nga shtetet anëtare, duke përfshirë zhvillimin e dokumenteve opsionale uniforme evropiane për qytetarët.
4. Qytetarëve t'u lehtësohet lëvizja ose veprimi përtej kufijve, në mënyrë specifike në ballafaqimin me grupe të ndryshme të rregullave tatimore dhe, në veçanti, për të shmangur tatimin e dyfishtë.
5. Lehtësimi i njohjes së certifikatave për lëvizjen e sigurt të automjeteve, duke e bërë më të lehtë dhe më të sigurt për qytetarët udhëtimin me makinë në një vend tjetër të BE-së.
6. Mbështetje në krijimin e një karte invalide, të njohur reciprokisht në BE, për të siguruar qasje të barabartë brenda BE-së për përfitime të caktuara (kryesisht në fushat e transportit, turizmit, kulturës dhe rekreacionit).
7. Forcimi i të drejtave procedurale të personave të dyshuar ose të akuzuar në procedura penale, duke marrë parasysh situatën specifike të fëmijëve dhe qytetarëve në nevojë.
8. Rishikimi i Procedurës Evropiane për Kërkesa të Vogla për të lehtësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me blerjet në një vend tjetër të BE-së.
9. Hartimi i një modeli për shfaqje në internet të kërkesave kryesore për të qartësuar dhe lehtësuar krahasimin me informacione rreth produkteve digjitale.
10. Marrja e veprimeve për të siguruar se administratat lokale kanë mjete për të kuptuar plotësisht të drejtat për lëvizjen e lirë të qytetarëve të BE-së.
11. Sigurimi i udhëzimit të përshtatshëm për përdorues për uebfaqen qendrore të Evropës, ashtu që informatat se ku të drejtohen për të drejtat e tyre t'u bëhen qytetarëve më të qarta dhe më të lehta

12. Komisioni do të:

- promovojë vetëdijësimin e qytetarëve të BE-së për të drejtat e tyre të shtetësisë në BE, me një doracak që paraqet këto të drejta të BE-së në një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë;
- propozojë mënyra konstruktive për t'u mundësuar qytetarëve të BE-së që jetojnë në një vend tjetër të BE-së të ruajnë të drejtën e tyre për të votuar në zgjedhjet kombëtare në vendin e tyre të origjinës;
- eksplorojë mënyrat e forcimit dhe zhvillimit të hapësirës publike evropiane, bazuar në strukturat ekzistuese kombëtare dhe evropiane, për t'i dhënë fund fragmentimit aktual të opinionit publik nëpër kufijtë kombëtarë.

Raporti i BE-së për Shtetësinë 2013 ka përbërë pjesën kryesore të Vitit Evropian për Qytetarët 2013. Ai është bazuar në kontributet e qytetarëve që janë mbledhur përmes konsultimit të gjerë publik, përfshirë këtu një pyetësor në internet, anketat “Eurobarometer” mbi shtetësinë e BE-së dhe të drejtat zgjedhore, konferencat e palëve të interesit me shoqërinë civile dhe institucionet e tjera, takimet me ekspertë dhe të ashtuquajturat “Dialogë të qytetarëve”. Ai ka shërbyer për t'i ushqyer debatet gjatë gjithë Vitit Evropian të Qytetarëve, duke çuar drejt zgjedhjeve evropiane në vitin 2014.

Bizneset

Shembujt e mëposhtëm që përfaqësojnë arritjet në drejtësinë për zhvillim tregojnë se si këto politika kanë pasur ndikim në përmirësimin e jetës së përditshme të bizneseve.

Bashkëpunimi gjyqësor midis vendeve të BE-së në çështjet civile dhe tregtare forcon ligjërisht tregun e vetëm të BE-së. Legjislacioni aktual i BE-së përcakton rregullat e përbashkëta të BE-së për juridiksionin në çështjet civile dhe tregtare dhe kështu sqaron se cila gjykatë është kompetente në kontestet ndërkufitare. Kjo gjithashtu përfshin rregullat e BE-së që vendosin se cili ligji zbatohet në konteste të tilla dhe që lehtësojnë zbatimin e një vendimi të lëshuar nga gjykatat në një vend tjetër të BE-së. Që nga viti 2015, reforma e rregullave ekzistuese do t'u kursejë kohë dhe para bizneseve – sidomos ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme – meqë çdo vendim i marrë në një vend të BE-së do të njihet automatikisht dhe do të zbatohet në çdo vend tjetër të BE-së.

Një kompani me seli në Francë bën një kontratë ndërtimi me një kompani me seli në Poloni, në të cilën gjykatat e Varshavës përcaktohen si kompetente që të merren me çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me kontratën e tyre. Rregullat e BE-së sigurojnë që të respektohet vendimi i gjykatës të Varshavës, edhe në qoftë se, për shembull, ndërtesa duhet të ndërtohet në Paris; dhe që vendimi i marrë nga gjykata polake do të njihet automatikisht dhe do të zbatohet kudo në BE, duke përfshirë edhe Francën.

Për të mundësuar funksionimin normal të tregut të vetëm, procedurat evropiane lehtësojnë rimëkëmbjen e borxhit ndër-kufitar. Urdhri Evropian për Pagesa mbulon kërkesat monetare ndër-kufitare, civile dhe tregtare, thjeshton procedurat dhe përshpejton procesin duke reduktuar kostot e procesit gjyqësor. Urdhri Evropian për Pagesa njihet dhe zbatohet në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian (BE), me përjashtim të Danimarkës, pa nevojën e një deklarate të zbatueshmërisë.

Një bastore austriake ka punuar me një kompani italiane që ka mbledhur baste nga zyrat lokale të basteve italiane dhe ka dërguar të holla te kompania austriake. Kur marrëdhënies kontraktuale i erdhi fundi, kompania austriake kuptoi se kompania italiane i kishte ende borxh një shumë të madhe të hollash. Kompania austriake u paraqit para gjykatës austriake dhe brenda disa muajsh fitoi Urdhrin Evropian për Pagesa, i cili u njoh automatikisht dhe u zbatua në Itali.

Rregullat e BE-së për praktikatat e padrejta tregtare kanë për qëllim të sigurojnë, promovojnë dhe mbrojnë konkurrencën e ndershme. Legjislacioni i BE-së siguron që konsumatorët të mos mashtrohen apo të ekspozohen ndaj marketingut agresiv dhe që çdo kërkesë e bërë nga tregtarët në BE të jetë e qartë, e saktë dhe e vërtetuar. Rregullat sjellin harmonizim dhe njohje reciproke në mes të shteteve, duke mposhtur barrierat e tregut të brendshëm. Bizneset janë në gjendje të reklamojnë produktet e tregut dhe shërbimet të të gjithë konsumatorët në BE, në të njëjtën mënyrë si të klientët e tyre vendorë.

Së fundi, rregullat e BE-së për pamundësi për të paguar ndër kufij të ndryshëm janë modernizuar, me qëllim të lehtësimit të bizneseve të shqetësuara, që janë aktive në shtetet e ndryshme anëtare të BE-së. Në vitin 2014, Komisioni Evropian rekomandoi që shtetet anëtare të BE-së të reformojnë ligjet e tyre kombëtare për pamundësi pagese, për të lejuar që një biznes të adresojë vështirësitë e tij financiare në një fazë të hershme dhe të reduktojë periudhat e lirimit nga borxhi për sipërmarrësit e falimentuar, duke promovuar kështu dhënien e shanseve të dyta. Komisioni gjithashtu mbështet iniciativat vullnetare që promovojnë menaxhimin e diversitetit në biznese, në veçanti statutet e diversitetit. Një statut i diversitetit është një dokument i shkurtër i nënshkruar vullnetarisht nga një kompani ose institucion publik. Ai përshkruan masat që do të ndërmerren për të nxitur diversitetin dhe mundësitë e barabarta në vendin e punës, pavarësisht racës ose përkatësisë etnike, orientimit seksual, gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar dhe fesë. Mbi 7 100 kompani, duke përfshirë ndërmarrjet, organet publike, OJQ-të dhe duke mbuluar mbi 13.6 milionë punëtorë, kanë nënshkruar 13 statute kombëtare të diversitetit të krijuara në të gjithë BE-në deri më tani. Në vitin 2014 u miratua një direktivë mbi zbulimin e informacionit jo-financiar dhe të diversitetit nga kompanitë e caktuara dhe grupet e mëdha. Kompanitë e interesuara do të duhet të japin informacione shpjeguese mbi politikën, rreziqet dhe rezultatet në lidhje me çështjet mjedisore, aspektet



© Sebastian Duda/Fotolia

Neve na duhen procedura ligjore efikase për t'u mundësuar kompanive që të zhvillohen.

sociale dhe të ndërlidhura me punëtorë, respektimin e të drejtave të njeriut, anti-korrupsionin dhe çështjet e mitmarrjes, dhe diversitetin në bordin e tyre të drejtorëve. Këto rregulla të reja do të zbatohen vetëm për disa kompani të mëdha me më shumë se 500 punëtorë.

Një kompani e vogël me seli në Irlandë është e specializuar në produkte natyrore të mirëqenies, të cilat janë veçanërisht të shquara për turistët francezë dhe gjermanë. Këta turistë shpesh kërkojnë më shumë produkte që t'u dërgohen me postë. Drejtori donte të reklamonte dhe shiste produktet e tij direkt në Francë dhe Gjermani, ndoshta duke zhvilluar uebfaqen e tij, por duke mos qenë i njohur me ligjet kombëtare në këto vende, ai ishte i shqetësuar për problemet e mundshme ligjore. Në sajë të rregullave të BE-së, bizneset e të gjitha madhësive janë në gjendje të shpenzojnë më pak për këshilla ligjore lidhur me mënyrën e të qenit në përputhje me rregullat jo të njohura për reklamim dhe marketing, dhe janë në gjendje të tregtojnë prodhimet e tyre në mbarë Evropën.

Përmirësimi i jetës së qytetarëve Romë në Evropë

Romët – minoriteti më i madh etnik në Evropë — ka qenë pjesë e Evropës me shekuj, mirëpo shpesh është ballafaquar me paragjykim, jotolerancë, diskriminim dhe përjashtim.

Qytetarët Romë jetojnë në Evropë në kushte shumë më të këqija socio-ekonomike se sa popullsia e gjerë, për shembull:

- vetëm 42% e fëmijëve Romë përfundojnë shkollën fillore, krahasuar me një mesatare të BE-së prej 97,5%;
- ata përballen me shkallë më të ulët të punësimit dhe me shkallë më të lartë të diskriminimit;
- ata shpesh nuk kanë qasje në shërbimet themelore, të tilla si ujë apo energji elektrike;
- jetëgjatësia për Romët është 10 vjet më e ulët se sa mesatarja e BE-së.

Vendet e BE-së dhe institucionet evropiane kanë përgjegjësi të përbashkët për të përmirësuar përfshirjen sociale dhe integrimin e Romëve, përmes shfrytëzimit të të gjitha instrumenteve dhe politikave për të cilat ata janë përgjegjës. Që nga viti 2011, një Kornizë e BE-së për

strategjitë e integritit të Romëve, e cila është në fuqi deri në vitin 2020, ofron ndihmë për shtetet anëtare për të bërë një ndryshim konkret në jetën e popullit Rom. Çdo vit, Komisioni monitoron progresin e arritur në implementimin e të gjitha strategjive kombëtare për integrimin e Romëve, të cilat strategji janë miratuar në kuadër të kësaj Kornize.

Për më tepër, në dhjetor 2013, të gjitha vendet anëtare të BE-së janë zotuar në një rekomandim të Këshillit për të ndërmarrë masa efektive për integrimin e Romëve, me qëllim të përshpejtimit të ndryshimeve në situatën e Romëve. Këto masa përfshijnë masa të politikave në arsim, punësim, qasje në kujdesin shëndetësor dhe strehim, por edhe masa në fushat e mosi-diskriminimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe grave Rome, fuqizimit të aktorëve vendorë dhe bashkëpunimit transnacional. Ky rekomandim shton një instrument të ri në aspektin juridik dhe politik, por më e rëndësishmja, ai përfaqëson një angazhim politik të fortë dhe unanim nga shtetet anëtare për të bërë më shumë dhe për të bërë përpjekje më të mira për të arritur përmirësime reale.

Vlerësimi i Komisionit për Progresin 2014 të gjendjes së Romëve ka konfirmuar nevojën për përpjekje të mëtejshme të qëndrueshme për të sjellë ndryshime në një shkallë më të gjerë. Sfidat kryesore që mbizotërojnë janë ndarja e vazhdueshme e fëmijëve Romë në shkolla / klasa të veçanta, mungesa e masave sistematike për të rritur pjesëmarrjen e Romëve në tregun e punës,

mungesa e mbulimit shëndetësor themelor për të gjithë në shumë shtete anëtare të BE-së, dhe getoizimi në qytete ose ndarja në zonat rurale. Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, politikën e zakonshme duhet gjithashtu të jenë më përfshirëse dhe më të përgjegjshme ndaj nevojave të Romëve.

Në Samitin Evropian të Romëve, që është mbajtur në prill 2014 në Bruksel, vendimmarrësit më të lartë vendorë dhe të BE-së janë pajtuar që autoritetet lokale dhe rajonale luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në integrimin e Romëve dhe kanë paraqitur nevojën për fuqizimin e kapacitetit në autoriteteve lokale dhe rajonale.

Fuqizimi i aktorëve lokalë si dhe i Pikave Kontaktuese vendore të Romëve është një parakusht i nevojshëm për suksesin e strategjive për integrimin e Romëve në shtetet anëtare të BE-së.

Përfitimet e integritit

Romët përfaqësojnë një pjesë në rritje të popullsisë në moshë pune, me një moshë mesatare prej 25 vjeç, krahasuar me mesataren e BE-së 40 vjeç. Kërkimet e Bankës Botërore sugjerojnë se integrimi i plotë i Romëve mund të sjellë përfitime ekonomike prej rreth 0.5 miliardë € në vit duke përmirësuar produktivitetin, duke zvogëluar faturat e mirëqenies dhe duke rritur faturat tatimore.

Vështrim: fuqizimi i qytetarëve dhe promovimi i zhvillimit

Përmirësimi i jetës së përditshme të qytetarëve të BE-së është një proces i vazhdueshëm. Në "Raportet e saj të Shtetësisë", BE-ja përcakton veprimet konkrete që synojnë heqjen e pengesave të mbetura në një zonë evropiane të drejtësisë. Një treg i vetëm për qytetarët duhet të trajtojë pengesat e panevojshme burokratike për lëvizjen e lirë. Për këtë qëllim, BE-ja ka propozuar, për shembull, lehtësimin e procedurave për qarkullimin e dokumenteve të gjendjes civile përmes kufijve. BE-ja do të forcojë më tej të drejtat e personave të dyshuar apo të akuzuar. BE-ja i kushton vëmendje të veçantë grupeve më të cenueshme në shoqëri dhe do të mbështesë vendet e BE-së në përpjekjet e tyre për të rritur integrimin social dhe ekonomik të Romëve.

Besimi i konsumatorit është çelësi për rritjen e kërkesës dhe rimëkëmbjen e zhvillimit. Strategjia e përgjithshme e Komisionit për konsumatorë, ashtu siç është mishëruar në Agjendën Evropiane të Konsumatorit, tregon se si të drejtat e konsumatorëve ndihmojnë në ruajtjen e këtij besimi. Përderisa inkurajohen konsumatorët dhe bizneset

për të përfituar nga zhvillimet më të fundit në botën digjitale, BE-ja do të sigurojë që të mbrohen të dhënat personale në internet. Reforma e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave do të heqë barrën e bizneseve dhe do të reduktojë burokracinë për ndërmarrjet, duke u larguar nga "mozaiku" aktual ligjorë dhe duke ofruar një përmbledhje të qartë të rregullave ligjore. BE-ja kërkon të përmirësojë më tej kushtet për biznes duke propozuar një instrument për zgjidhjen alternative të kontesteve në mes të kompanive, duke ju drejtuar reklamave krahasuese mashtruese dhe të pandershme, dhe duke modernizuar legjislacionin për pamundësi pagese. BE-ja propozon që të përmirësojë kthimin efektiv të aseteve kriminale, për të forcuar sanksionet kundër falsifikimit të euros, dhe për të mbrojtur interesat financiare të BE-së përmes ligjit penal. Zyra e ardhshme e Prokurorit Publik Evropian do të zhvillojë hetime dhe ndjekje penale efektive dhe efikase në të gjithë BE-në në mënyrë që mashtrimi ndaj buxhetit të BE të mos mbetet pa u ndëshkuar. Duke vazhduar përpjekjet e saj për të luftuar trafikimin e drogës, BE-ja do

të përcaktojë se çfarë përbën vepër penale dhe se çfarë ndëshkimesh përbën ajo, derisa do të adresojë edhe zhvillimin e shpejtë të substancave të reja psiko-aktive.

Forcimi i ligjit të BE-së për të trajtuar diskriminimin dhe për të siguruar se ai zbatohet në mënyrë efektive në të gjitha vendet e BE është një objektiv kryesor për BE-në. BE-ja është e angazhuar për t'u dhënë të gjithëve një të drejtë të mirëfilltë për të përfituar plotësisht nga tregu i vetëm, duke jetuar dhe duke punuar të lirë nga diskriminimi për shkak të gjinisë, racës apo përkatësisë etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës dhe orientimit seksual. Prandaj, një prej prioritetëve në vitet e ardhshme do të jetë miratimi i propozimit për mbrojtje më të mirë kundër diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, moshës, fesë apo besimit dhe orientimit seksual jashtë fushës së punësimit dhe profesionit. Për më tepër, BE-ja përpaket që të zvogëlojë dallimin në paga bazuar në aspektin gjinor dhe - nga një tjetër propozim për miratim - që të rrisë pjesëmarrjen e grave në bordet e kompanive të listuara, për të ndihmuar thyerjen e barrierës diskriminuese që i pengon gratë të tregojnë potencialin e tyre profesional.

Nëse qytetarët dhe bizneset do të shfrytëzojnë plotësisht tregun e vetëm të BE-së, ata do të kenë nevojë për qasjemë të lehtë në drejtësi, me kushte të barabarta në të gjitha vendet. Rregullat për gjithë BE-në janë të nevojshme. Por, vendet e BE-së inkurajohen gjithashtu që t'i bëjnë sistemet e tyre gjyqësore më efikase dhe të zbatojnë reformat e nevojshme gjyqësore, si pjesë e programeve të tyre të rimëkëmbjes ekonomike, duke kontribuar kështu në politikën e drejtësisë për zhvillim.

Pavarësia e sistemit të drejtësisë dhe respektimi i sundimit të ligjit janë dy nga vlerat themelore mbi të cilat është ndërtuar Bashkimi Evropian. Sundimi i ligjit dhe pavarësia e gjyqësorit janë thelbi i BE-së, dhe duhet të respektohen në të gjitha 28 shtetet anëtare të BE-së. Zona evropiane e drejtësisë është ndërtuar mbi njohjen e ndërsjellë dhe besimin reciprok. Për të funksionuar siç

duhet, zona evropiane e drejtësisë ka nevojë për besim: besim në sistemet gjyqësore të njëri-tjetrit dhe besim në autoritetet gjyqësore. Një sistem efikas dhe i besuar i drejtësisë do të sjellë një dividendë ekonomike.

Besimi se sundimi i ligjit mbizotëron nënkupton besimin për të investuar në atë ekonomi. Në kontekstin e monitorimit gjashtë-palësh në Evropë, "Semestri Evropian", Komisioni Evropian tashmë ka shumë instrumente për të matur dhe për të krahasuar zhvillimet ekonomike dhe sociale në një shtet anëtar të BE-së, ose për të vlerësuar efikasitetin e administratës publike.


Që nga viti 2014, BE-ja ka zhvilluar një mjet të ri - "Tabela e BE-së për Rezultatet në Drejtësi" - për të promovuar sistemet efektive të drejtësisë në Bashkimin Evropian dhe në këtë mënyrë për të përforcuar rritjen ekonomike. Tabela e BE-së për Rezultatet në Drejtësi ofron të dhëna objektive, të besueshme dhe të krahasueshme mbi funksionimin e sistemeve të drejtësisë në 28 shtetet anëtare të BE-së. Përmirësimi i cilësisë, pavarësia dhe efikasiteti i sistemeve gjyqësore tashmë janë pjesë e procesit të koordinimit të politikave ekonomike të BE-së në kuadër të Semestrit Evropian, i cili ka për qëllim hedhjen e themeleve për një rimëkëmbje të zhvillimit dhe krijim të vendeve të punës.

Tabela e BE-së për Rezultatet në Drejtësi 2014 mbledh së bashku të dhëna nga burime të ndryshme. Shumica e të dhënave sasiore janë dhënë nga Këshilli i Komisionit të Evropës për Vlerësimin e Efikasitetit të Drejtësisë (CEPEJ), i cili mbledh të dhënat nga shtetet anëtare të BE-së. Tabela e BE-së për Rezultatet në Drejtësi 2014 gjithashtu paraqet rezultatin e dy studimeve pilote, të cilat japin të dhëna më të hollësishme për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në lidhje me ligjin për konkurrencë dhe të drejtën e konsumatorit, e shprehur në ditë mesatare.

Të gjeturat kryesore të Tabelës së BE-së për Rezultatet në Drejtësi 2014 kanë treguar se:

- Disa shtete anëtare vazhdojnë të përballen me sfida të veçanta në lidhje me efikasitetin e sistemeve të tyre të drejtësisë. Procedurat e gjata të shkallës së parë, së bashku me numrin e vogël të rasteve të zgjidhura apo numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura, theksojnë nevojën për përmirësime të mëtejshme. Ndërsa reformat ambicioze janë miratuar kohët e fundit në shtetet anëtare të caktuara (për shembull në Portugali), efektet e tyre ende nuk mund të reflektohen në Tabelën e Rezultateve, meqë të dhënat janë kryesisht nga viti 2012.
- Disponueshmëria e mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për gjykatat është

Një prej prioritetëve të BE-së është fuqizimi i të drejtave të qytetarëve.



rritur, megjithatë ka ende vend për progres të mëtejshëm, në mënyrë të veçantë në krijimin më të lehtë të kontakteve në mes të gjykatave dhe qytetarëve.

- Mekanizmat alternativë për zgjidhjen e kontesteve janë tani në dispozicion në pothuajse të gjitha shtetet anëtare, ndërsa monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve të gjykatave ekziston në shumicën e shteteve anëtare
- Gati në një të tretën e shteteve anëtare të BE-së shkalla e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në aktivitete të vazhdueshme të trajnimit për ligjin e BE-së është mbi 50%. Trajnimi i gjyqtarëve dhe zyrtarëve ligjorë dhe mjeteve TIK janë thelbësore për funksionimin efektiv të një zone evropiane të drejtësisë, të bazuar në besimin e ndërsjellë.
- Në disa shtete anëtare, perceptimi i pavarësisë është përmirësuar, ndërsa në disa shtete të tjera anëtare ai është përkeqësuar.

Tabela e BE-së për Rezultatet në Drejtësi kontribuon në Semestrin Evropian duke ndihmuar në identifikimin e çështjeve të drejtësisë që meritojnë vëmendje të veçantë. Bashkë me vlerësimin specifik të situatës në shtetet anëtare, tabela e BE-së për Rezultatet në Drejtësi 2014 ka kontribuar në adresimin e [rekomandimeve specifike sipas vendeve](#) në fushën e drejtësisë për 12 shtetet anëtare (Bullgari, Irlandë, Spanjë, Kroaci, Itali, Letoni, Hungari, Maltë, Poloni, Rumani, Slloveni dhe Sllovaki.). Këto rekomandime u miratuan nga Këshilli Evropian në korrik 2014. Si një hap tjetër, shtetet anëtare duhet të zbatojnë këtë udhëzim të politikave, si pjesë e përpjekjeve të tyre për të rritur zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Komisioni do të raportojë mbi progresin e arritur në zbatim në vitin 2015.

Për më shumë, vizitoni

- Informata gjithëpërfshirëse dhe të përditësuara për të gjitha politikat e drejtësisë në: <http://ec.europa.eu/justice>
- Në Facebook: <http://www.facebook.com/EUJustice>
- Na ndiqni në Twitter: http://twitter.com/EU_Justice
- Informata për sistemet e drejtësisë dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi kudo në BE, në 23 gjuhë: <http://www.e-justice.eu>
- Informata dhe detaje kontaktuese për konsullatat dhe ambasadat e shteteve të BE-së në shtetet jashtë BE-së: <http://ec.europa.eu/consularprotection>
- Ndihmë dhe këshilla për qytetarët e BE-së dhe familjet e tyre lidhur me udhëtimin, punën dhe pensionimin, arsimin, shëndetësinë, formalitetet e banimit, automjetet etj. në: http://europa.eu/youreurope/citizens/index_en.htm
- Udhëzues praktik për të bërë biznes në Evropë: http://europa.eu/youreurope/business/index_en.htm
- Uebfaqja për të drejtat e fëmijëve për fëmijë dhe të rinj; e cila përmban lojëra, filma vizatimorë, video dhe artikuj të shkurtër për t'u ndihmuar atyre që të mësojnë më shumë për të drejtat e tyre dhe mënyrën se si BE-ja ndihmon në mbrojtjen e këtyre të drejtave: <http://ec.europa.eu/0-18>
- Pyetje për Bashkimin Evropian?
Linja telefonike Evropa Direkt: 00 800 6 7 8 9 10 11
<http://europedirect.europa.eu>

